

Vendim nr. 210, datë 25.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 25.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (L) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: LAURANT CAKOLLARI

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor brenda afateve ligjore, tejkalimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe mohimit të së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë.
Urdhërimi i marrjes së masave për rivendosjen e të drejtave kushtetuese, duke përfshirë zhvillimin e gjykimit brenda afateve të arsyeshme ligjore.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së; nenet 71/a dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 24.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës me kërkesë për deklarimin si të shuar dhe mosekzekutimin e dënimit të dhënë ndaj tij me vendimin e formës së prerë nr. 846, datë 28.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mosekzekutimin e pjesës së mbetur prej 2 vjetësh e 8 muajsh nga vendimi penal i formës së prerë, si dhe përjashtimin e tij nga vuajtja e mëtejshme e dënimit. Me vendimin nr. 55-2025-1218, datë 18.09.2025, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

2. Ky vendim rezulton të jetë shpallur në seancë gjyqësore dhe, në kushtet e mosarsyetimit të tij brenda afatit ligjor 30-ditor të parashikuar nga neni 382, pika 2, i Kodit të Procedurës Penale (KPP), kërkuesi i është drejtuar kësaj gjykate me disa kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës që ka gjykuar çështjen, duke pretenduar, ndër të tjera, se moszbardhja në kohë e vendimit krijonte dyshime të arsyeshme për objektivitetin e paanësinë e saj, i jepte përparësi organit të ndjekjes penale, si dhe cenonte të drejtën e ankimit të tij (kërkuesit) në një gjykatë më të lartë.

3. Pas marrjes së mendimit me shkrim të gjyqtarës së çështjes, bazuar në nenin 22 të KPP-së, me vendimin nr. 1717 (106), datë 21.12.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës (me trup gjykues të përbërë nga tjetër gjyqtar) ka vendosur papranueshmërinë e kërkesës së kërkuesit të datës 19.12.2025, me arsyetimin se mbrojtësi i tij nuk kishte parashtruar në prokurë shkaqet e përjashtimit të gjyqtarës, sipas parashikimeve të nenit 19, pika 4, të KPP-së, dhe, në kushtet kur gjykimi kishte përfunduar e kërkesa për përjashtim nuk ishte paraqitur gjatë kësaj faze, ajo kishte mbetur pa objekt.

4. Po kështu, me vendimin nr. (135) 9, datë 07.02.2026, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka vendosur papranueshmërinë edhe të kërkesës së kërkuesit të datës 06.02.2026 për përjashtimin e gjyqtarës së çështjes, me arsyetimin se kërkesa nuk plotësonte kushtet formale, nuk ishte shoqëruar me shkaqe të reja ose elemente faktike e juridike të ndryshme nga ato që ishin shqyrtuar më parë dhe kërkuesi kishte marrë përgjigje për pretendimet e tij me vendimin e datës 21.12.2025 të saj.

5. Në datën 04.05.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuessit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* dhe *e drejta e ankimit* në një gjykatë më të lartë, të garantuara nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, si rrjedhojë e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Sipas kërkuessit, ndonëse kanë kaluar mbi 7 muaj, vendimi vazhdon të mbetet i paarsyetuar, në shkelje të afatit ligjor 30-ditor të parashikuar nga neni 382, pika 2, i KPP-së dhe afatit të zgjatur, të parashikuar nga pika 4 e këtij neni, ndërsa kërkesat e tij të përsëritura për dhënien nga gjykata të arsyeve për shkaqet e vonesës kanë mbetur pa përgjigje.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Kolegji vëren se një kriter tjetër që duhet të plotësohet nga kërkuesi është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të

përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesit, të cilët përpara se t'i drejtohen Gjykatës duhet të vërtetojnë se kanë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në lidhje me cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 38/2017*), Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese dhe se individ duhet t'i shfrytëzojë ato përpara se t'i drejtohet asaj (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individ duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës drejtpërsëdrejti, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe së drejtës së ankimit, si rrjedhojë e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës brenda afateve ligjore.

12. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se procesi gjyqësor përfshin edhe periudhën kohore nga momenti i shpalljes së vendimit deri në zbardhjen e tij (*shih vendimet nr. 5, datë 23.02.2016; nr. 18, datë 31.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit duhet të vlerësohet në secilin rast sipas rrethanave të veçanta dhe duke iu referuar këtyre kriterëve: kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkuesit, sjelljes së autoriteteve përkatëse, si dhe asaj çfarë kërkuesi rrezikon (*shih Frydlender kundër Francës, datë 27.06.2000, §43*). Në raste të ngjashme ajo ka vlerësuar se, pavarësisht problemeve të ngarkesës së gjykatave, kërkuesit kanë të drejtën që procesi i tyre të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm, i cili përfshin edhe shkrimin e vendimit të arsyetuar (*shih B. kundër Austrisë, datë 28.03.1990, § 52-54; Rash kundër Rusisë, datë 13.01.2005, § 25*).

13. Në këtë drejtim, Kolegji vë në dukje se ligji procedural penal, në nenin 384 të tij, parashikon se vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit. Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim dhe në mënyrë të përmbledhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Në këtë rast gjykata u jep palëve në seancë vendimin e përmbledhur me shkrim. Ndërsa, sipas nenit 382, pika 2, të KPP-së, kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.

14. Nisur nga sa më lart, Kolegji vëren se procesi gjyqësor përfshin edhe hartimin/shkrimin e vendimit të arsyetuar dhe dorëzimin e tij në sekretarinë gjyqësore, prandaj mjetet juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së gjejnë zbatim edhe në rastet e vonesës në arsyetimin e vendimit gjyqësor. Në këtë kontekst, në ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument dhe nuk ka paraqitur ndonjë provë se ka përdorur mjetin juridik në dispozicion të tij për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, në kuptim të parashikimeve të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, si dhe se kjo kërkesë nuk ka rezultuar efektive në drejtim të përshpejtimin të këtij procesi nga ajo gjykatë.

15. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, përpara se t’i drejtohet Gjykatës. Për rrjedhojë, pretendimet e parashtruara prej tij në ankimin kushtetues individual nuk mund të merren në shqyrtim.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.